



Datë: 13 Mars 2014

Vendi: Prishtinë

**TAKIM NDËRINSTITUCIONAL PËR THEMELIMIN E KOMITETIT KOSOVAR PËR DITËN E INTERNETIT TË SIGURT**

**(QENDRA PËR STUDIME TE AVANCUARA FIT - MASHT – AMDP - PTK )**

Më 12 Mars 2014 u themelua Komiteti Kosovar për Ditën e Internetit të Sigurt (këtej e tutje „KKDIS“). Themelimi i komitetit KKDIS do të avancoj përpjekjet e përbashkëta të institucioneve publike, private, dhe shoqërisë civile për të nxitur dhe promovuar përdorimin më të sigurt dhe më të përgjegjshëm të internetit në mesin e fëmijëve dhe të rinjëve në Kosovë. Në mes tjerash, KKDIS do të bashkëpunojë me organizatat ndërkombëtare – Insafe and Safer Internet Day për shenimin e Ditës Ndërkombëtare të internetit të sigurt. KKDIS do të jetë e njohur nga INSAFE, si organ dhe pikë kontakti për të gjitha aktivitetet për Ditën e Internetit të Sigurt.

Emri - “Komitetit Kosovar për Ditën e Internetit të Sigurt”

Anëtarët themelues:

1. Teuta Zymeri – Përfaqësues i Qendrës për studime të avancuara FIT
2. Shkumbin Gashi –Përfaqësues i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
3. Ruzhdi Jashari - Përfaqësues i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
4. Besnik Skenderi - Përfaqësues i Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës Sh. A.

Udhëheqës i “ Komitetit Kosovar për Ditën e Internetit të Sigurt ” (këtej e tutje „KKDIS“), do të jetë nga Qendra për studime të avancuara FIT. KKDIS do të jetë i hapur edhe për palë të tjera të interesuara. Komiteti do të takohet së paku njëherë në gjashtë muaj.

**Teuta ZYMERI**  
Qendra për studime  
të avancuara FIT

**Shkumbin GASHI**  
Ministria e Arsimit  
Shkencës dhe Teknologjisë

**Ruzhdi JASHARI**  
Agjencia Shtetërore  
për Mbrojtjen e të  
Dhënave Personale

**Besnik SKENDERI**  
Posta dhe  
Telekomunikacioni  
i Kosovës Sh. A.